



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VI

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 7

Prishtinë, më 29.1.2018, në orën 11:30

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Daut Haradinaj, Srdjan Mitrović, Besa Gaxherri, Liburn Aliu, Lutfi Zharku, Andin Hoti, Enver Hoti dhe Salih Salihu.

Munguan: Danush Ademi, Ganimete Musliu dhe Driton Çaushi.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku dhe Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi, **Daut Haradinaj**, kryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më **19.1.2018**;
3. Votimi i Raportit vjetor 2016 për gjendjen e mjedisit;
4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguri Bërthamore;
5. Shpallja e konkursit për drejtor të Agjencisë së komplekseve memoriale të Kosovës;
6. Formimi i grupeve punuese për nismën legislative rreth hartimit të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-042 për rregullimin e shërbimeve të ujit dhe nismën legislative për hartimin e Projektligjit për cilësinë e bukës;
7. Shqyrtimi i kërkesës së Shoqatës së Verëtarëve “Enologjia”, për mbështetje për eksportin e verërave dhe heqjen e akcizës në verëra;
8. Të ndryshme.

Kryesuesi, pasi i përshëndeti anëtarët e komisionit, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

Deputetja **Besa Gaxherri** e mori fjalën dhe alarmoi komisionin rreth gjendjes së mjedisit për shkak të ndotjes së ajrit në shkallën jonormale, ndaj pas diskutimeve të shkurta komisioni konstatoi se është urgjente të mbahet një mbledhje menjëherë dhe u vendos që kjo të bëhet më 30 janar 2018 në orën 12,00, kur do të ftohen aktorët kryesorë institucional për të diskutuar se çfarë mund të bëjnë për këtë gjendje institucionet tona.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 19.1.2018

Kryetari i komisionit konstatoi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së kaluar.

3. Votimi i Raportit vjetor 2016 për gjendjen e mjedisit

Pasi që në mbledhjen e kaluar është diskutuar për Raportin vjetor 2016 për gjendjen e mjedisit, komisioni njëzëri miratoi këtë raport dhe rekomandoi mbledhjes plenare miratimin.

4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguri Bërthamore

Për Projektligjin për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguri bërthamore gjithashtu u rekomandua mbledhjes plenare për miratim në leximin e parë, mirëpo në vazhdim anëtarët e komisionit **Besa Gaxherri, Liburn Aliu, Enver Hoti, Andin Hoti, Lutfi Zharku, Salih Salihu**, si dhe kryetari **Daut Haradinaj** kërkuan nga kryeshefi **Beqir Mezelxhiu** sqarime për gjendjen aktuale në këtë agjenci dhe sa arrin ajo të përthekojë obligimet ligjore që i takojnë dhe a ka agjencia bashkëpunimin e duhur institucional.

Kryeshefi u përgjigj: Kjo agjenci ka nevojë për bashkëpunim sidomos me këtë komision, deri tani ka krijuar rrjetin e tillë me policinë, organet kufitare dhe me tjerë. Agjencia ka dy funksione themelore, licencimin dhe inspektimin, mirëpo problemi themelor është zbatimi i ligjit përkundër faktit se punon në bazë të ligjit autokton bazuar në BE, d.m.th. infrastruktura për zbatimin e ligjit siç janë shërbimet teknike dhe profesionale. Së pari, përkundër ndihmës së madhe nga ambasada e SHBA-së dhe bashkëpunimit me Belgjikën rreth disa analizave të ujit, tokës e uraniumit të varfëruar, kjo agjenci nuk ka laboratorin për analiza radiologjike, një deponi ku do të mbaheshin mbeturinat radioaktive (përkundër faktit që këtë e kanë Trepça dhe KEK, por ata nuk lejojnë të përdoren ato nga tjetër kush), rreth alarmimit për sëmundje kancerogjene nga rrezatimet dhe antenat e ndryshme, popullata njoftohet përmes spitaleve ku dërgohen materialet e nevojshme dhe mund të konstatojmë se popullata është vetëdijesuar për këtë problematikë, gjithashtu për vendet ku ka pasur bombardime nga NATO është vepruar sipas kërkesave të ndryshme, por edhe zyrtarisht se a ka dëme radiologjike për popullatën.

5. Shpallja e konkursit për drejtor të Agjencisë së komplekseve memoriale të Kosovës

Për drejtor të Agjencisë së komplekseve memoriale të Kosovës u vendos që të shpallet konkursi edhe pse ka kohë edhe 6 muaj, por procedurat duhet të zbatohen sipas ligjit. Anëtarët **Andin Hoti dhe Lutfi Zharku** sugjeruan për disa kushte të konkursit të cilat do të eliminohen nëse ka nevojë, tha **kryetari** pasi që ende do të diskutohen në vazhdim dhe të cilat janë të parapara edhe me ligjin në fuqi për këtë agjenci.

6. Formimi i grupeve punuese për nismën legislative rreth hartimit të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 05/L-042 për rregullimin e shërbimeve të ujit dhe nismën legislative për hartimin e Projektligjit për cilësinë e bukës;

Për nismën e hartimit të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 05/L-042 për rregullimin e shërbimeve të ujit u vendos grupi punues në këtë përbërje: **Besa Gaxherri**-kryesuese, **Daut Haradinaj** dhe **Liburn Aliu** anëtarë, kurse për nismën për hartimin e Projektligjit për cilësinë e bukës, kryesues u zgjodh **Salih Salihu** i cili do të njoftoi komisionin kur është i gatshëm materiali për të filluar me grupin punues.

7. Shqyrtimi i kërkesës së Shoqatës së verëtarëve “Enologjia”, për mbështetje për eksportin e verërave dhe heqjen e akcizës në verëra

Rreth kërkesës së shoqatës Enologjia për çështjen e verërave, komisioni konstatoi se do të jetë më e kompletuar shqyrtimi nëse ftohet edhe përfaqësuesi i tyre për të konstatuar saktë se çfarë dëshirojnë, ndaj kryetari premtoi se pas bisedimeve me ata do të vendosë kur do të ftohen në komision. **Enver Hoti** dhe **Lutfi Zharku** konstatuan avancimin e Kosovës me kualitetin e verërave për eksport, megjithatë insistuan që komisioni të kërkojë paraprakisht mendimin e Qeverisë për këtë çështje apo do të mjaftojnë vetëm ndryshimet që kërkon shoqata të bëhen në ligjin që është në fuqi për verëra d. m. th. ndryshimet për eksportin dhe heqjen e akcizës.

8. Të ndryshme.

Kryetari **Daut Haradinaj** i njoftoi për një shkresë posa të arritur në komision, e cila sugjeron inicimin e sërishëm të nismës së hartimit të Ligjit për kompleksin Adem Jashari, e cila nismë në legjislacionin e kaluar posa ka filluar është stopuar për shkak të përfundimit të legjislacionit, kështu ka mbetur edhe fondi financiar, ashtu si është i rezervuar dhe nuk mund të përdoret nëse nuk përfundon ligji, ndaj kërkoi deklarin e komisionit për të filluar prapë procedimin, për çka komisioni parimisht u pajtua dhe do të vazhdojë në mbledhjen e radhës të miratohet kjo nismë dhe do të caktohet grupi punues.

Mbledhja përfundoi në orën 13:30.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetar i komisionit,

Daut Haradinaj